



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/59;
Datë: 31.07.2015 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.07.2015 nxjerrë:

V E N D I M

**për hapjen e diskutimit publik për
plotësim-ndryshimet e Rregullores së tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2016**

- I. Me këtë vendim **hapet diskutimi publik** për plotësim-ndryshimet e Rregullores së tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2016/në tekstin e mëtejme plotësim-ndryshimet e Rregullores/.
- II. Plotësim-ndryshimet e Rregullores nga pika I. e këtij vendimi vihet në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i plotësim-ndryshimeve të Rregullores do të bëhet në zyrën numër 7 të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i plotësim-ndryshimeve të Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 10.08.2015 dhe përfundon më: 24.08.2015).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik plotësim-ndryshimet e Rregullores ekspozohen edhe në ueb faqen e Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i plotësim-ndryshimeve të Rregullores organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të këtyre plotësim-ndryshimeve.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

XII. Vendimi iu dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës së Junikut;
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
3. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
4. Shërbimit të Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivit të Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://kk.rks-gov.net/junik>